


BSH-1

B 92

NONDA BULKA

SODITJE



TIRANE, 1957

891.983-1

B 92

NONDA BULKA

5

891.983-1
B 92

24829

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

SODIT JE

11663

LIBRARI I PUBLIKUAR SHTETËRORE
SHTETËRORE E BOTIMEVE

NDËRMARRJA SHTETËRORE E BOTIMEVE

TIRANË, 1957

LIRIKA

Flet Partia

Kur sulmante pik'e djalit
Majë malit,
Dhe kur pisha e vandalit
Digjite foshnjatë në djep,
Dil një zë nga palc'e tokës
Shqipëtare,
Dhe përplasësh mbi armikun
Si batare:
«—Bjeri më të lumtë dora,
Bëja fora!
Jam me ty si mish e thua,
Mos u trëmb se më ke mua.»—
Kush flit kështu, ndërsa fryn
E çfryni stuhija?
Flet Partia!

Dhe kur hasmi i xhalavitur,
Shkumëzonte i lebetitur,
Dhe me thik'e me litar,
Çdo pëllëmbë dhe një var ...
Kush buçit përmes tërmetit
Mu si dallg'e fort'e detit:
«Popull mos iu trëmb stuhisë,
Po agon dit' e lirisë!
I s h t e zë r i i P a r t i s ë .

Mbi gërmadhat ndriti djelli,
Mijra yj xixëllon qjelli
Ç'u përbys kjo bot'e vjetër,
Duhet ngritur bota tjetër,
Bota jonë, pa padronë!
Cep më cep buçet jehona,
Oshëtin dhe mal dhe det.
Përsëri Partia flet!

Ja! Në fshat llamburit dritë,
Dhe shkëmbinjtë po rrëzohen
Thellë që nga themelitë!
Djersë, këngë në çdo hap
Edhe lumi u bë zap!
Pa u thanë plot moçale,
Pa u çanë plot kanale,
Dhe po ngrihen mbi lumenj
Hidrocentrale.

Kush i dha vrull punëtorit?
Kush i dha zjarr kraharorit
Të lëvizë pistoletin,
Goxha shkëmb ta hedhë n'erë?
Kush po sjell ndër ne pranverë,
Një pranverë të paparë
Tjetër herë?

Buzë Vjosës, anës Bunës
Lavdi Ty, Parti e Punës!

Në agim të Komunizmit¹⁾

Dy lumenjtë gjarpërojnë,
Njeri tjetrit drejt i shkojnë.
Dhe me vrull po përqafohen,
Kur takohen.
I flet Vollga lehtë-lehtë,
Donit t'qetë:
«—S'po më dukesh aq i qetë,
Siç të quajnë shkrimtarë
Dhe poetë!
Vala jote po gjëmon;
I rrëmbyer shtratin tim
Sot po sulmon!—»

«—Vollga, Vollga lum'i gjerë,
Zérin tënd shpesh e kam ndjerë,
Kur në stepat suferina
Ulërinte,
Gjer në gjirin tim arrinte.
Namin kam se jam i qetë,
Ujrat rrjedhin si rrufe
Siç po shkon dhe bot'e re.
Vala ime në vrapim
Seç këndon lavdi, fitim.
Po ti Vollgë, si ke shkuar?—»

«—Shpesh në shekujt e kaluar,
Vala ime ka rënkuar,

1) Me rastin e hapjes së kanalit Vollga-Don.

Kur me qindra mijë skllevër,
Të damkosur,
Mbi kto ujra zvarrë-zvarrë,
Gjoksat lidhur me litarë,
Nën kamzhikun e tiranit,
Hiqnin barkat Car-Sulltanit.
Në Totor shtatëmbëdhjetë,
Shkrepëtijnë vetëtimat
E rrufetë,
Jo nga qjelli, jo nga retë,
Po nga toka e zhuritur!
Vegjëlia e uritur,
Ishte ngritur.
Zbardhëlloi! Ylli Leninit
Llamburiti.
Dhe nga maja e Kremlinit,
Botën ndriti.—»
Ja pret Doni me habi:

«—Esht' e njejtë histori,
Eshtë e njejtë mrekulli,
Gjatë brigjetë të mij!
Kur Lenini dha kushtimin,
Bot' e re kundroi agimin.
Bot' e vjetër u përbys,
Dit'e saj u vrenjt, u ngrys,
Tok' e gjërrë e vaditurë
Me lot,
Shkoi në duart e të zot.
Dhe në çdo pesëvjeçar,
Kthehet dimri në behar.
Kur pa-pritur...
Dymbëdhjet vjet më parë,
U sulmuan këto anë
Nga barbarë,

Xhinxhis-Hanë, Tamerlanë,
Kapérxyer,
Seç u nxinte mu në gjokës.
Kryq'i thyer.
Përséri gjak e lëngatë!
Dhe ata që kapardisur,
Zbardhnin dhëmbët të hazdisur,
Të përgjakur brekë-grisur,
Në greminë i mbajtën këmbët!
Mbi Rajshtagun e Berlinit,
U ngrit flamur'i Leninit.—»

Dy lumejtë oshëtijnë,
Dhe gjëmojnë:

—«Nëpër shekuj, do këndojmë,
Valat tonë do gjëmojnë,
Sinfoni të pa dëgjuar,
Dit'e madhe po afron
Ja! Agimi i Komunizmit
Z b a r d h ë l l o n !

Buçet lumi

Pse buçet ky lum'i Matit?
Pse ushton jehona shpatit?
Dallg'e thinjur shkumëzon,
E gjëmon!
Vallë ç'mund të ketë ngjarë?
Kush e di ç'haber ka marrë!
U hap lajmi vetëtimë
Në Tiranë:
—«Dritë, jetë vegjëlisë,
Anembanë!»—
Fjal'e dalë prej Partisë,
Buzëqesh foshnja në sisë!
Ndaj buçet ky lum'i Matit,
Kur me vrull vërshon prej shpatit.
Po flet lumi rëndë-rëndë:
—«Gjer më dje si i tërbuar,
Udhëtoja i harbuar,
Mbillnja tmer, përhapja zi,
Më mallkonte plak e i ri.
Një nga një do laj gjynahet.
Gjithë fajet!
Sot e tutje tërë populli
Kreshnik,
Do më quaj — «Lumë-mik!
Shekuj duke udhëtuar
Sa kam par'e kam dëgjuar...
Sa kujtime.....
Fsheh e ruan zemra ime!

Mu ne der'e fukarasë,
Pashë Vdekjen të trokasë!
Pranë foshnjesë pa gojë,
Pash' Urinë të përgjojë
Pashë nënën të lotojë.
Shkuan shekuj...
Shkum'e bardh'e valës sime,
U bë gjak!
Kujë, vajë, shkatërrime
Më çdo prak.
Dhe një ditë...
Nëpër qjej të Shqipërisë
Zbardhi drita e Lirisë!
Pashë kullën e bajrakut
Të rrëzohet,
Pashë vatrën e bonjakut
Që të ngrohet!
Dhe atje ku Met Zogolli
Varfëri e skamje mbolli,
Sot i jepet vëndit dritë,
Që nga Mati në Mirditë,
Peshkopi e Kruj'e Shkodër
Po ndriçohet fush'e kodër,
Myzeqe, Fier, Berat,
Çdo fabrik'e kombinat!
Sipër malesh bie borë,
Po s'të ngrin;
Ulërin tufan nér pyje
S'të mërdhin,
Ja! Po fryn një tjetër erë,
Dimri kthehet në Pranverë!
Po kush vall më jep kuvet
Të zgjerohem sa një det?
Unë plak të bëhem djalë,
Të lëviz hydrocentralë?

Gjegjet bjeshk'e malësisë,
Gjëmon zër' i vegjëlisë;
— Ndihm'e madhe e Bashkimit
Sovjetik,
Zëmrën ton'e bën çelik;
Shkëmb - granit éshtë Partia,
E çeliktë Miqësia!»

Gumëzhin krenare vala,
Malësis'i çon të fala.

Bir i vegjëlisë

— Ti luan bir vegjëlie
Ku ke qënë,
Qindra vjet që s'të ka parë
Vëndi tënë?
Kur errsira kish pllakosur
Dhe kur nata s'kish të sosur,
Kur as qjelli s'kishte yje,
Kur mbulonte mugëtira,
Mal'e pyje,
Ku ke qënë? —

— Nëpër pranga kam jetuar
I munduar!
Në farmak e vrer i zhytur,
Gadi në skëterrë mbytur,
Po i gjallë, jo i vdekur
Zëmër-hekur!
Shpesh zinxhirat i kam tundur,
Male, dete, kam lëkundur,
Dhe si mbytesha në gjak,
Më shkelmonte ujku plak.

Në një natë të Nëndorit
Fort tëngrirë,
Kur zvarritesha i mpirë
Në zhinxhirë,
Një shqiponjë sy-petriti,
Me dy krahe prej graniti,
Mu ne shtrofka e mjerimit
Më trokiti:

— Ngreu skllav, të erdhi dita,
Për të verbrit zbardhi dita,
Jam me ty si mish e thua,
Eja pas se më ke mua! —

Dhe u zgjova! Dhe lëftova!
Gjaku det, po e fitova!
Copë-copë u bë zinxhiri,
I sh Partia që më thirri!

Mbi një vatër të nxirosur,
Mbi një truall të shkrumbosur,
Mbeta zot!
Po kasollja e zhuritur,
Duhësh ngritur!
Dhe ky vënd duhesh vaditur,
Jo me gjak e jo me lot,
Po me djersën e të zot!
Ndaj tani po, çaj tunela
E bëj malin thela-thela,
Thaj këneta, hap kanale,
Ngre me vrull hidroçentrale.

Dhe kjo baltë,
M'u bë mjaltë!
Se një yll më ndrin përpara,
Mbi traktorët nëpër ara,
Nënë tokë, në minierë,
Atë yll e shoh përherë:
Yll i ndritur Sovjetik
Që më jep hov e vërtik.

Emri im? Ç'e do ta dish?
Mija, mijë ne se ç'jemi,
Veç një emër neve kemi:
Jemi ajk'e vegjëlisë,
Shtyll'e hekurt e Partisë!

Majë shkrepit

Atje lart mbi mal tē thatë
Kuvendojnë gjér'e gjatë;
Dy filiza majë shkrepit,
Një i dushkut, një i plepit.

«—Kur shikoj nga larg kopetë,
Që po ngjitenë përpjetë,
Zë lëkundem si purtekë.
Oh, sa frikë kam nga dhitet,
Po më dridhenë kërcijtë!—»


Fërfëllin filiz'i plepit
Majë shkrepit.

Hidhet dushku e i thotë,
Shokut që i rrjedhin lotë:

«— Ajo dorë që na solli,
Dhe me aq kujdes na mbolli,
Do tē dijë tē na mbrojë,
Se për neve ka nevojë—»

— S'po marr vesh në çfarë punë,
Mund tē hyjmë ti e unë. —

— Pas pak vjet do jemi burra,
Pa me ne do ngrihen ura,
Plot shtëpi, goxha pallate
Dhe fabrika, kambinate.



Pa me ne do bëhet kartë,
Ku do shkasë pen'e zjarrtë,
Pen'e zjarrtë, pen'e artë,
E poeit gojë-mjaltë.
Do shikosh pas disa vjet,
Sa i madh do jesh o plep!
Do ndryshojmë dhe natyrën,
Shkrepit do ja ndrrojmë ngjyrën...
Po ç'e do, se jam i vogël,
S't'i them dot, se s'më lë era,
Sa-e-sa gjëra të tjerá...»

Qesh filizi majë shkrepit,
Fërfëllin gjethja e plepit!

Bilbili, kanarina, dhe traktori


Një bilbil, një kanarinë,
Kuvendojnë të mërzitur
Mbi lëndinë.

— Që kur erdhi kjo maqinë,
Na e prishi qetësinë,
Kam tri dit që sy s'po mbyll,
Në korije as në pyll.—

— Ka tri ditë që edhe unë,
Nuk po bëj asnje sy-gjumë.
Sa të urtë ishin qetë,
Çanin tokën lehtë-lehtë,
Edhe ne u shkonim pas
Gjithë gaz!—

— As më thua kanarinë,
Kush e ngjet atë maqinë?
Atë hekur që s'ka kokë-
Që s'ka këmbë,
Që s'ka gojë, sy, as dhëmbë?—

— Nuk e di, o bilbilo,
Po shiko . . .
Atë tokë që dy buaj,
Do ta çanin për një muaj,
Kjo maqinë që buçet,
E thërmoi
Për dy dit'e për dy net.
Duhet vajtur, duhet parë,
Si e çau aq shpejt ugare.



Hesht traktori . . .
Zbriti djali që të çlodhet
Te lëndina,
I shkoi pas dhe kanarina.
Zbriti vajza që të çlodhet
Te trifili,
I shkoi pas edhe bilbili . . .
I këndonte kanarina ciu, ciu, ciu
Një skifteri flokë-ziu,
I këndon bandill bilbili
Vashës faqe-trëndafili . . .
Kanarina dashuroi o vetullzinë,
Dhe bilbili atë vashë gjeraqinë.

Zoqt e pyllit u mësuan,
Me traktorë u pajtuan.
Kur buçimatë pushojnë,
Kanarina dhe bilbila
Cicërojnë:
Një pranvere të pasosur
I këndoijnë.

Bir i herojt

— As më thua o nëno,
Cili quhet sot hero?

Foli Shpendi i gëzuar
Me gazetën nëpër duar.

— Është ay që trim mbi trima,
Ndërsa frynte suferina,
Hasmit i qëndroi si shkëmb,
Kurrë syri nuk iu trëmb!
Mori plagë, po s'u dha!
E çpoi plumbi, po s'u vra!
Emri i tij s'harrohet kurrë,
Ja ndriçon l a v d i a nurë.

C'po rri Shpendi i menduar
Me gazetën nëpër duar.

— Ati im, a është hero,
O nëno?

— Dëgjon shkëmbin si ushton?
Dëgjon malin si gjëmon?
Ja atje punon yt atë,
Atje mori dekoratë!
Po ia ndrron vatanit faqen,
Luftëtar, besnik për paqën.

Ndaj mbi gjoksin mban nishane,
Shpirt o xhane.
Po akoma s'ësht' hero,
O biro!

— Pse gazeta sot ka shkruar,
Se im atë është dekoruar
Se ay është hero?
Ja, shikoje, o nëno!

Shikon nëna në gazetë
Një portret të burrit t'vetë
I rrjedhin nga faqet lehtë
Dy lot gazi si kristali,
Si lum nëna, si lum djali!

Vajza dhe lulja

Në fushat e pambukut, thëllënëxëza mitare,
Ç'ia thotë gëzim-plotë, një kënge lozonjare!
Dhe mu si bor'e malit zbardhon një fush'e tërë
Ashtu si zbardhëllojnë ato të dyja llërë,
Që lulen e pambukut këpusin lehtë-lehtë.
Dhe lulja e mërzitur sy-zezës i ankohet,
Ngalalë, émbël-émbël, fillon t'i përgjërohet:
—«Pse më venit pranverën pse më këput të shkretën?

Jam gonxh'e re akoma, tashti po gëzoj jetën!»

Ndërsa mpleks një gërshtet,

Vasha fillon e flet:

—Për ty tani nisjeta, o lule bukuroshe,
Kur ti bashkë me shoqë do futesh nëpër koshe.
Pa do spastrohesh mirë, do krihesh e do lahesh,
Si vajzë përkëdhelur do mburresh e do mbahesh.
Me saltanet do hipësh pastaj n'otomobil,
Do hysh si nus'e bukur në Kombinat'tekstil.
Do nisesh e stolisesh si flutur ngjyra-ngjyra,
Sa nuk do të të njihet as trupi as fytyra.
Krenare, madhështore do rritesh e do rritesh,
Nër fshatra e qytete, në male lart do ngjitesh.
Me ty do zbukurohen dyqane madhështore,
Do të shkëlqesh m'e bukur nga stina pranverore.
Pëlhura, dok, këmisha, prej teje do të dalin,
Do veshësh të gëzuar si plakun, si dhe djalin.
Dhe gocës nazeqare do t'i dhurosh fustane
Me kinda an'e ane.
Rinija jote lule, tashti porsa fillon . . .
Shiko! Një fshat i tërë për ty kremton, këndon.



I këndoij Partisë

C'do këndoje vjershëtori,
Q'i del afsh nga krahërori?
Këtij pesmbëdhjetvjetori?

Do këndoje popullin tënë,
Dje me njerkë, sot me nënë.

Sot i gjallë, plot shëndet,
Ngjitem gërxhevet përpjetë,
Majë malit gjer te retë:
Se atje gjej frymëzime
Ku çdo shkëmb ruan kujtime,
Ku dhe gurit i çkëputet
Psherëtim'e krenari,
Prej kraharorit,
Oh, për gjakun e dëshmorit!
Ku çdo shkozë, çdo murris
Po bën roje,
Mbi një var të vegjëlisë

Frymëzim kam shkrepë, pyje,
Rreth e rrrotull gjelbërimë,
Të qindisura me yje
Ku ngre çerdhen shqipja trime.
Frymëzim gjej ndër lugina
Ku ka çfryrë suferina,
Ku buçet Vijosa plakë
Dhe tregon me oshëtimë

Për dragoj në tym e flakë
Që në vetull t'mernin gjak!
Frymëzim gjej në Selitë,
Ku dhe nata lëshon dritë!
... Ndér Uzina, Kombinate
— Fishkëlle me gaz sirenë
Dit'e natë,
Dhe përhap si vetëtima
Oshëtima!
Ja! shtëllunga tymi ngrihet,
Vëndi im po përtërihet,
Po sulmon njeriu i ri,
Dhe lëfton me gaz në buzë.
Ç'po buçet ti o rini,
Kryet lart e synë shpuzë
Për Parti.

Mbi çdo gjë e mbi të gjitha
Do këndoja si në përrallë
Trimëreshë, yll në ballë,
Ty Parti plot me lavdi,
Që me dritën e Kremlinit
Na jep jet'e lumturi!

Mujo Ulqinaku

C'janë ata që nxijnë detin?
E dëgjon, nëno, tërmëtin?
— Jan' hordhitë e dushmanit,
Për t'i vënë zjarr vatanit
O biro!

— C'janë ata këmishë-zes,
Që po vinë aq serbes,
Me ca pupla si këndes.
O nëna ime?

Ata janë mizërira,
Që po vinë me zinxhira,
Të na lidhin këmb'e kokë,
E ta kthejnë varr'e gropë,
Cdo luath, çdo fush'e pyll,
Do nxirosinë çdo yll!
Pa do bushin me kufoma,
Me kufoma, ah, të njoma
Cdo kodrin'e e çdo hendek
Mal më mal e breg më breg.

— Zjarr nga deti, zjarr nga qjelli!
Nëno, u sterrua djelli!

* * *

— Durrës ty, o Durrës plak,
Hasmi po të shkel në prak,
Populli u mbyt në gjak!

C'po lëfton një ulqinak.
Lëfton djali, lëfton plaku
Gjer në gju na vate gjaku,
Bjeri Mujo Ulqinaku

Për liri!

Lufton populli i arbreshit,
Si dikur me pallë sheshit
Për Shqipri.

Thrret Guzzoni: Mamma mia.
C'burra paska Shqipëria!

Telegramet ven'e vinë
Nga Llondoni në Athinë,
Nga Belgradi n'Amerikë,
Nga Azia në Afrikë;
Nga Parisi gjer në Moskë:
C'po luftojnë geg'e toskë
Për një truall pér një prak,
Lahen rrugëtë me gjak!

Kush lufton ashtu më këmbë?
Kush ha hekurin me dhëmbë?
Janë trimat shqipëtarë,
Që po heqin zorrët zvarrë!
Të tradhtuar nga një mbret,
Q'u degdis pér një kurbet!

Është Mujua, një kapter,
Që lufton e vdes me nder!

Dhe ja plumb'i mallëkuar,
Tej-pér-tej në kraharuar!
C'na u mbyt trimi në gjak,
Pér një truall, pér një prak.

Nëna me të madhe qan,
Kur sheh shtrir' atë luan:
— Gjirin ta kam bër' hallall,
Xhan o shpirt, me yll në ballë!
Ti m'u vrave për liri,
Ndaj të qan një Shqipëri,
Bir o bir si lumthi ti!

Shkëmbi i shqiponjave¹⁾

Nëpër gërxhet e Mirditës,
Po i hapet rrugë Dritës!
N'ato male ku sundonin
Markagjona,
Shkrep më shkrep gjëmon jehona:

— Hapu shkëmb, mos ha inat!
Mjaft e mbajte kryet lart!
S'i sheh krushqit e dasmorët
Që për Ulëzë po shkojnë?
Lumin venë të martojnë!
Kjo s'ish parë as në ëndërr,
Që ta nisin lumin dhëndërr!
Po ti qënke kokë-shkëmb
Ndaj vendosa të të shëmb,
Shkëmb o shkëmb! —

Hem krenar, hem i hutuar,
Ja kthen shkëmb'i zemëruar:

— Mijra vjet në këto rrëza,
Plot me çerdhe për thëllëza,
Shqipe malesh e skifterë
Kam strehuar:
Po askush nuk ka guxuar,
Të më thotë: «Luaj vëndit!»

1) Këtë emër mban shkëmbi më i math që u hoth n'erë për hapjen e rrugës së Dritës, buzë lumit të Matit.

Sikur t'isha pend'e shpendit!
Ti djalosh me pistolet
Me kë matesh, kujt i flet?
Unë jam Shëmb'i shqiponjës! —

— Edhe unë o kokë-shkëmb,
Jam një minator sulmonjës! —

Dhe fitilit i dha flakë,
Shpell'e tërë u përflak:
Oshëtin thellë lugina,
Po kremon tërë krahina,
Ç'po na hapet rrug'e Dritës!
Mes-për-mes nj'asaj Mirditës!
Cop'e thrime rrokulliset,
Shkëmbi plak tej në luginë,
Si errsira që zvarriset
Në greminë.

Vala dhe djali

— Ti o val'e bardhë e bardhë,
Shkumbë-bore përmbi det,
As më thua nga ke ardhë,
Aq me vrull e salltanet? —

— Zhurmë-madhe vij nga lark,
Ngre stërkallat sa një mal,
Shkumëzoj rrëth e përqark,
Gjëmë-madhe jam o djalë! —

— E kujt bijë je ti valë,
Që na mbahesh aq krenare,
Që buçet aq e furishme,
Si një breshër me batare? —

— Jam e bija e tufanit,
Dal nga gjir'i oqeanit:
Po ty çun azgan sy-det,
Që serbes me mua flet,
Syt'e tu ku t'i kam parë?
Mos je fis me marinare? —

— Ish një natë Shënëdrew,
Kur im atë më tregonte,
Si në det ai peshkonte,
Se si ujet shkumëzonte,
Egër deti nxinte, nxinte,
Barkën donte ta përpinte.
Më në fund n'atë përlleshje



3 — Frymëzime ngajeta e re

Ay dolli fitimtar
More vesh tashti o valë.
E kam babën marinar!

Ku ta dish ti çun i mitur,
Sesa trima kam gëlltitur,
Sesa nëna kanë qarë,
Sa të rinj e sa të thinjur,
Në gjë tim e kanë varrë . . .

Dëgjo valë e furishme,
Ti që je aq e fuqishme,
Atin tim mos ma trazo!
E kam shpirt, e dua shumë,
A dëgjon valë me shkumë,
Më premto! . . .

Ushton vala ulerin,
Asnjë fjalë s'pipëtin . . .

Murmurit djaloshi trim:
— Heshtja jote nuk më trëmb,
Se im atë e ka zëmrën
Më të fortë se një shkëmb!
Në çdo ndeshje do të dalë
Fitimtar,
More vesh o val'e thinjur
E panginjur.
E kam babën marinar!

Këngë labërisht

Kurvelesh, zëmëra ime,
Kurvelesh,
Ç'janë këto bombardime,
Kurvelesh!
Kurvelesh-o-gur e shkëmb,
Kurvelesh,
S'ka mortajë që të shëmb,
Kurvelesh!

«—Këngë labërishte,
Këng'e zëmrës s'ime,
Ç'po më ngjall sërish
Sa e sa kujtime . . .
E ëmbël, e vrazdë,
Mbi kto malet tonë,
Ç'po ushton ndër shekuj
Si rrufe jehona.
O këng'e brumosur,
Në lavdi e vaj,
Me shpirt të brengosur,
Krenohem e qaj.—»

— Kush je ti shqiponj'e malit,
Q'i ke dhënë sisë djalit
Trim me fletë,
Që ka varrin atje poshtë
Te rrëketë?—

«Lart mbi ato brigje,
Tej nér ato shtigje,
Në shi e në borë,
Atje ku kullosin
Deshtë me këmborë:
Ligjëroj krenare,
Këngë shqipëtare.
Fyellit i bije:
Këngë trimërije,
Këngë labërije!—»

— Mos je ti në këto rrëza,
Plot dragoj plot fëllëza,
Që këndon e qan astritë
Pallë-xhveshur,
Nga ata që dhe me Mortjen,
Ballë për ballë janë ndeshur? —

— Qindra vjet më parë,
Ç'lemeri kam parë!
Kafshatën kam ngjyer,
Në lot e farmak.
Kur digjej kasollja,
Kur prishej kopeja,
Më dukesh se binte,
Zjarr rrufe nga reja.
Po s'u dhashë kurrë,
E kam zëmrën burrë,
Nëpër këto ckërka
Edhe vetë gratë,
Kur ndjejnë mandatë,
Bëhen si nepërka.
Ndaj këndoij krenare,
Tokën shqipëtare.

Këndova Gjolekët,
Që me pallë sheshit,
Prinin në kto gryka,
Bijt'e Kurveleshit.
Qava Bilbilejtë,
Që si kapedanë,
Në litarë vanë
Që të trembëdhjetë. —»

— Kush je ti moj krahë-erë,
Buzë shkrepit me skifterë,
Që heq ison zvarrë-zvarrë,
I këndon dragojt të vrarë,
Si një dhëndrrri me kurorë
Kur shkon nusen për të marrë? —

— «Jam bij e vatanit,
Jam afsh'i tufanit,
Jam flokëz'e borës!
Djali më ka rënë,
Në luftën e Vlorës,
Tjetri me tre plumba,
Gjoksin plagë-shkruar,
Në kto gërxhe rrötull,
Për Parti e popull
Jetën ka dhuruar! —»

— Kush ta ka stolisur,
Ballin si shteg mali,
Atë trup t'hazdisur,
Kush vallë ta fali?
Kush të ka qindisur
Me at ngjyrë ergjëndi,
Kush ta çelnikosi,
Zëmrën mu si shkëmbi? —

— Zëmrën si stuhija,
Ma farktoi Partija!
Ngjyrën e fytyrës
M'a dha drit'e hënës!
Shtatin e hazdisur,
M'a dha gjir'i nënës!
Syrin m'a qindisi,
Pënda e pëllumbit,
Nishanin e ballit
Një e fshikur plumbbit!
Kur u zhytën malet,
Në tym e në gjak,
Ç'u ndez zëmra ime
Si barut në flak!
Pra nisi stuhija
Ç'u tund Labërija!

Flakëruan vetëtimë
Këto maja nga mortaja.
Dhe gjëmoi. Dhe kërcënoi
E egërsuar,
Gryk'e Kuçit Gryk'e keqe:
Kurrë hasmit s'i tha: peqe!
Pra na shkeli këmb'e huaj
Këtë baltë,
Që me lot e gjak vaditur,
Është e ëmbël mu si mjaltë.
Bora që zbardhonte malet,
M'u duk porsi një qefin,
Që mbulonte vëndin tim.
Kur m'u hap toka si varr,
Kënga ime mori zjarr!
Copë u bë këmishëziu
Gjak-përlyer,
Në greminë u rrrokullis
Dhe kryqi-thyer . . .

Po breshk'e moçalevet
Rrézoi dren'e malevet!
Dhe kënga në grykë,
M'u duk se shterroi
Tej nga lindja hodha sytë,
Pashë si shkëlqenin yjtë:
Përmes mijra mijra dritave
Në quell,
Pashë Një që xixëllonte,
Porsi diell!
Printe zëmrat e dragojvet,
Në mejdan,
Mu mbi 'të shkëlqente drapër
E çekan!
Rrez'e tij plot frymëzime,
I dha zëmër, zëmrës sime!

Bir'i shqipes u rilind,
Binte Një, dilnin një qint!

* * *

Dhe kur muzgu nis e bije,
Varem poshtë si një hije,
Shkoj e shmallem buzë pérrojt,
Pranë varrit të herojt.
Brengë zëmrën ma ka marrë
Pér petritin tim të vrarë.
Shumë malli më ka zënë,
Pér petritin tim të rënë.
E kam djalë, më ka nënë!

Sot këndojo pranverën,
Qiellin pa re,
Diellin, lulet, erën,
Një botë të re!

Sot këndoј kopenë,
Fushën, Myzeqenë,
Pa zgjedhë, pa bej
Tërë atdhenë e dashur.
Tej e përkëtej.
Këndoј ëmbël-ëmbël,
Fushat plot blerime,
Ligjëroj e qetë
Lumin dhe rrëketë,
I kam gjak ndër deje,
Gjak të zëmrës sime.
Atje mbi kodrinë
Këndoј dashurinë.
Kur na vjen pranvera,
Pa zë lëmon era
Flokëzat e mijë,
Rri pranë çapkenit,
Që pret majë lëmit
Dhe këndon brengosur:
«Dil moj qën'e qënit,
Se plasa i gjori,
Këtu majë lëmit!»
Me të hyr' të prillit,
I lutem bilbilit:

—«Tregomë dhe mua
Nga këngët e tua,
T'ia këndoј në krua,
Asaja që dua!»—
Ligjëroj krenare,
Botën shqipëtare,
Fusha, pyje, male,
Që mbushen me drithë,
Me hidroçentrale.
Këndoј botën tonë
Me qindra miljonë,

Ku ka lidhur besë
Shqipërija jonë.
Shiko sa jam rritur!
Si jam përtëritur,
Yll'i Kremlinit,
Zëmrën ma ka ndritur.
Sot këndoj Partinë,
Lavdinë, lirinë,
Jetën, lumturinë,
Lule Shqipërinë.
Jam Zana e paqës,
Jam Zana e jetës,
Këng'e së vërtetës.

Shqipëri zëmëra ime,
Shqipëri,
S'ka tashti më bombardime,
Shqipëri!
Kush guxon të prek një qime,
Shqipëri,
Bëhet copë e bëhet thrrime,
Shqipëri.
Nëntë qint e ca miljonë,
Shqipëri,
Mbrojnë këto viset tonë
Shqipëri.
Shqipëri e fortë shkëmb,
Shqipëri;
S'ka mortajë që të shëmb,
Shqipëri!

Legjenda e një zëmre

Na ish dikur një nënë
Dhe kjo na kish një bir,
Një bir si xhevahir,
Ta pije në një kupë!
E lumja ajo çupë,
Që do ta kish kësмет.
E donte nëna djalin,
Si bebëzat e syrit.
Për 'të ajo drithmohesh,
Për 'të sa përgjërohesh!
Kushdo që e shikonte
— Ptu mashallah — i thonte.
Po nëna kishte frikë,
Nga nonjë sy i lik,
Ndaj pranë zëmrës mu në gji,
I qep të birt një hajmali ..

Një ditë ngjau ajo që ngjau,
Në një greminë djali shkau!

Një vashë magjistare,
Gjarprushe-lozonjare,
Në zëmër e kafshoi!
Dhe djali, shpirti nënës,
Nëpërkën dashuroi!

Dhe nën'e lebetitur,
I thosh zëmër-lënduar,
Të birt të adhuruar;

— Hiq dorë nga nepérka,
Ne jemi fukarenj!
S'na sjellin veçse kobe
Hoxhaqet e mëdhenj!—

Kaloi një kohë . . .
Një ditë gjarpër pikëloshi,
I pëshpërit atij djaloshi:
—Vërtet më do aq shumë?
Po ti s'je gjë or lumë!
Ti s'bën asgjë për mua.
O nënën, ose mua!
Ti qënke frikacak ! . . . —
Dhe thellë mu në zemër,
I hodhi pak farmak . . .

Dhe buzën i a afroi,
Dhe lehtë e kafshoi.

Me tallje, me përbuzje,
Nëpërkëza vazhdoi:
—«Vërtet? Vërtet më do?
Po nëna jote shtrigë,
Pse qënka aq e ligë?
Përse don të na ndajë?
Shko, vri atë murtajë
Dhe sillma këtu zëmrën,
Bushtrës t'ia heth ta hajë!
Ahëre, veç ahëre,
Dhe un do jem për ty
Dhe ti do jesh për mua! —
Dhe për të tretën herë,
Në buzë e kafshoi!
Dhe djalit zëmër-vrarë,
Gjithë helmin ia lëshoi.



Ahere ngjau ajo që ngjau
Në një humnerë djali shkau!

Si tigër i xhindosur,
Me shpirt e trup-plagosur,
Djaloshi, ik e ik,
I dukej se nga prapa
E ndiqte xhind'i lik . . .
Si hije e skëterrës
I jep një shkelmë derës . . .
Dhe nënën xhalavit
Nga gjiu zëmrën ia ç'qit!
Ia çkul zëmrën e artë,
E shtjell në një cop'kartë,
Dhe si i çmendur del:
Mbi dhe këmba s'i shkel.
Asgjë rrugës s'shikon,
Veç syt'e gjarpërushes,
Ato vecë ëndërron!
Kur po vraponte në sokak,
Gremiset, qorolliset,
Rrëzohet, mbytur-gjak.

Ahere ngjau ajo që ngjau . . .
Dhe guri i sokakut
I mallëngyer q a u !
Dhe kur po jepte shpirt,
Në vesh dikush i pëshpërit:
—M'u vrave shum o xhan, o shpirt?—
Kish folur zëmr'e nënës!
Kish folur zëmr'e artë.

E bardhë je o borë,
Mbi malet si kurorë,
Kur djelli të shëndrin!
Po ti o zëmr'e nënës
M'e bardhë vetëtin!

E fort'është rrufeja,
Që shkrepëtin nga reja,
I fort'ësht'oqeani,
Kur e tërbon tufani,
Po dashuri e nënës,
Qenka m'e fort' akoma,

M'e lartë nga çdo mal,
M'e bukur nga çdo yll,
M'e ndritur nga çdo diell
Që vezullon në qìell,
Edhe nga drit'e hënës
Veshur n'ergjënd e ar,
Na qënka zemr'e nënës.

Në zëmër të maleve tona

C'është ay që rri menduar,
Me një krrabë nëpër duar,
Shtang në vend i mallëngjyer,
Si shqiponjë krahë-thyer?

— Braho Salua, një bari,
Majë malit në vërri,
Kullot dhën e kullot dhi,
Ca të botës, ca të tij.

* * *

Frynte fladi lehtë-lehtë
Atë mëngjes,
Dhe nga qjelli lart mbi kreshta
Binte vesë.
Ra pranvera mbi vargmalet
E pësosur,
Veç te zemr'e çoban Brahos,
Dimri rëndë pat pllakosur!

* * *

Shtatë prill o ndaj të gdhirë,
Gjëmoi vala nga zinxhirë,
Krisi topi tej nga deti,
Ushtoi mali nga tërmeti!
Sterrë ujrat nga pamporë
Ç'u tund toka nga taborrë!

Ndaj pyet Braho Salua
Me habi,

Ndërsa po lehte Balua,
Qeni i zi:

— Kush shtyri kundra teje
Shqipëri?

Kush trëmbi dhënt' e mia
Në vërri? —

Mbi vargmalet e pasosur
I përgjigjet suferina
E xhindosur;

«— Një mynxyrë sjell barbari,
Të nxiroset kok'e këmbë
Shqipëtar!

Një qefin po sjell stuhija,
Që përtej nga Italia,
Që ta veshin të shqiponjës
Bij e bija!» —

Ulurin Adriatiku!

Vala-shkumë,
Çon jehonën e tërbuar,
Mbi Shkumin, Vijosë, Bunë.

Rë e zezë u përflak,
Përsëri trualli Arbit
U përgjak,
Se ky popull mbron vatanë,

Me një pushkë pa kondak.

Dhe Zogolli frikacak,
Mbleth florintë me harar
Prapa djellit thyhen qafën,
Si kusar!

* * *

Dhe bariu zëmër-lënduar,
Ndjen një lëmsh në kraharuar:
Ëndër sheh të llahtaruar,

Sikur nën'e tij e ndyer,
Na i çfaqet, zemër-thyer,
Q'e qorton me zémërim:
— O Braho, o biri im,
As më thua,
A je burrë, a je grua!
Se atje — te kur po dergjesha
Te gropă,
Ndjeva se körcisnin topa;
Dhe m'u duk se ti o bir,
Duar-kryq mbaje sehir!
Pra braktis bagti e stane
Shko atje ku po ñel flakë
Ose vish köto çitjane
Edhe tirqet bjermi mua,
Se ahe û një copë grua,
Do vulos nga ngryka topa,
Sa ta marrë vesh Avropa,
Se ky vënd shkëmbij e gurrë,
Nuk i jepet hasmit kurrë!»

* * *

Sikur zëmrën çoban Brahos,
Njëqind thika të ia çponin,
Kurrë aq fort s'do ta helmonin!
Rëndë-rëndë vështron Balua,
I habitur,
Praho Salon flokë-ngritur,
Atë burrë që s'pat qarë
As në djep,
Lotët fshehur kur gëlltet;
Sokëllin çobani malit
Zë-rrufe,
Kur shikon aeropllanin

Nënë re:

— «Zbrit te sheshi i mejanit,
O këlysh pjell'e shejtanit,
Një hesap të vjetër kemi,
O qafir, o qen bir qeni!—»
C'oshëtijnë thellë, thellë
Ato bjeshkë
« — Kape Balo, s'është zhgabë,
Është breshkë! — »
Dhe me grushta e me krrabë
Det e qiell kërcënon!
Hidhet Balua të sulmojë,
Po s'ka krahë të fluturojë.
Egërsohet ky çobani
Zëmër-enjtur,
Dhe në syt e tij të vrenjtur,
Egër ç'i spikat tufani!
Dhe si det i dallgëzuar
Shkumëzon në krahëruar,
Q'atë breshkë të moçalit
S'e kaç dot ky drê i malit!
Dhe pastaj i vrazhdë, i vrazhdë,
Shkon atje ku po del flak
Ku një popull i tradhtuar
Po spërkat rrugët me gjak.
S'kish dufek, as kish te pallë,
Po rrufe fshih në qepallë.
Dhe ndërsa po udhëtonte
Me një trastë hedhur supit
Ec' e ecë dit'e natë
Bukë-thatë,
Syt' i vanë vetvetiu,
Majë Qafës së Koçiut.
Ndofta solli ndërmërd tanë,

Që iu vra atje në Vlorë,
Kur me div Selam Musanë
Atë topn' e Italjanit,
E mbërtheu për pak me dorë.

* * *

Pastaj iku, iku, iku,
Andej tej nga vij armiku,
Nër gremina monopate,
Më s'u muar vesh rga vate...

* * *

Mbi shkëmbinj e në pllaheja,
Nis e blegërin kopeja.
Blegërijnë nëpër shkrepë,
Dhënt' e shkreta:
— «Si na la bariu të gjorë? —»
Psherëtijnë desht' e sqeptë
Me këmborë.
Si jetim kujiste Balua:
«Ku më vajti Braho Salua! —»

* * *

Nga mazgalla e gremina,
Fort buçiti suferira:
— Thonë e përpiu tufani,
Tutje bregut te mejdani. —

* * *

Nër zinxhira u mbërthye
Shqipëria!
Zjen nga brënda vegjëlia,
Tradhetin' ajo mallkon:
— «Ju që shitët vërdin tuaj
Ndër të huaj,

Njerëz me dyzet flamurë,
Mos ju trettë balta kurrë! — »

* * *

Në nëntor dyzet e një,
Që nga zëmr' e vegjëlisë
Del një zë:
Ishte zëri i Partisë!
Edhe shkëmbi mori zjarr!
Mu si kalë i harbuar
Turfullon i egërsuar
Çdo fashist e tradhëtar!
Ububu ç'ishte stuhija!
Dit e natë në shtrëngatë,
Carin shtigje bij' e bija,
Udhëtonin e sulmonin!
Nat' e zezë lart mbi male
Nëpër pyje,
Veçse rrugën u ndriçonte
Një fanar me mijra yje!
Mijra yje tej nga lindja
Xixëllonin,
Edhe rrugën e lavaisë
U tregonin.
Don ta dish ç'ishte stuhija?
Pyet ckërkat, shkrepat, brigjet,
Kodrat, gërxhet, çukat, shtigjet
Dhe ata do të rrëfejnë
Si u shkrua historija!
Pyet majat e Cukalit,
Ku sulmonte ajk' e djalit,
Pyet shkrepat e Ivarit,
Ku fole kish shqip' e malit
Mu ne zemr'e partizanit!

Pyet shpellat e Zarelit,
Shko e pyet nga Tomorri,
Çermenika,
Dhe atje do tē tē thonë,
Sesi bijt e kësaj toke,
As që dinin ç'është frika!
Shko e pyet ato gryka
E lugina,
Që i rrihte pa pushuar
Suferina,
Dhe ato do tē tregojnë
Si luftonin e si binin
Ata trima!
I dëgjon lumënjtë tanë
Kur vërshojnë?
Nëpër këng' e nér legjenda
Epopen e këti vëndi
Na tregojnë.
Këng' e tyre vaj-Lavdi,
E brumosur me barut
Në stuhi,
Kaçerxen det e kufi;
Përshkon botën anembarë,
Dhe shpërthen nér oqeanë,
Dhe tregon...
Se një popull aty buz
Adriatikut,
Kurrë nuk' iu dha armikut!
Ja dëgjo si ligjërojnë
Shtojzovalle n'ato pyje!
Xixëllojnë porsi yje.
Gush' e tyre me verojka
E rrëthuar,
Drit'e hënës atë gjokës

Ka mbuluar.
Kuvendojnë shtruar, shtruar...
Rreth furtunës së tërbuar
Se ç'tregon ajo perri
Derdhur flokët si flori
Me dy sy shkëndija zjarri
Sumbulla margaritari!
— «Atje thellë te përroi
I kam parë ata dragonj
Kur me ferrin na u ndeshën,
Gryka-grykës ç'u përleshën!
Mortja vetë u zu ngushtë,
Kur kundronte bijt e nënës
Që barut hanin me grusht.
Dhe e njirrur grykë-tharë,
Çirresh Mortja me llahtarë:
« — Me këta s'ia dalkam dot,
Zot, o zot!
Ky do jetë popull xhind
Bie një, ngrihen një qint. — »

* * *

I biri
Iku dimri...
C'po fryn flladi lehtë-lehtë,
Çdo mëngjes,
Dhe nga qjelli lart mbi kreshta
Bie vesë.
Qesh pranvera mbi vargmalet
E pasosur.
Një pranverë e pambaruar,
Që dhe zëmrën e çobanit
Ka pushtuar.

Po një natë pus të rëndë,
Aty rrreth dyzet e nëndë,

Nat'e thellë Shënëndreu!
Ç'ësh't' ay që sokëllin
Sa tundet dheu?
Çfarë don ai bir çobani
I vetmuar,
Mu në gji t'atij tufani
Të tërbuar?
Mu në zëmër t'atij pylli,
Ku harbojnë lukunira,
Bisha grumbuj të urtuar?

Humbi dhinë laragane,
Ndaj s'e trëmbin as rrëpira,
As tufane!
Kërkor dhin'e arratisur,
Ky bir mali kokë-krisur,
Pra ka dalë asaj korije,
Filli vetëm si një hije.
E çan pyllin tejpërtej,
Asgjékundi gjurmë dhije
Atë natë Shënëndreu
Kur buçit qjelli e ëheu!
Tek po ndillte laraganen,
Në një guvë nënë shkëmb,
Pa një zjarr dhe ngriu në vënë!
Përmes flakës sheh një burrë,
Që po rripte një lëkurë;
Pa menduar thellë-thellë,
Kalli kokën n'atë shpellë...
Tre hajdutë brrof në këmbë,
T'armatosur gjer në dhëmbë!
— Dhinë time lara-lara,
Pse ma therrët o kusarë?

Fjalën çuni s'e kish sosur
Një kusar i armatosur,
Iu përgjegj me butësi:
« — Hyrë brënda çun'i ri!
Sa për berën laragan,
Ta paguajm sa të thuajsh....
O çoban. — »
Dhe një qeskë me flori,
Ia vringlloj përpara hundës,
Si një kali të pangrënë
Kur i vënë,
Plot një trastë me tagji!
— Hyrë, hyrë, mcs ki frikë! —
— Qënki shumë pasanikë!
— Sot flori, nesër liri
A i vrarë,
Jemi puro Shqipëtar.

Ia kthen çuni vrazhdë, vrazhdë:
— U s'kullos në atë grazhd,
Atë «puro» û s'e pi,
U s'e ha atë tagji!
A i vrarë,
Qofshi puro shqipëtarë!
— Ne të blejmë një kope,
Dhi e dhën, e lop' e qe.
Për flamur, të bëjmë be! —
Fët e fët çuni ia pret:
— Për ç'flamur?
Se ju s'kini vetëm një,
Po dyzet!

Tatëpjetë çuni thyen,
Veç tre plumba e mbërthyhen!
Një e fshiku mu në ballë,

Një i dyt'e përcëllooi
Lehtë-lehtë mbi qepallë;
Dhe një tjetër më i rëndë
Iu ngul thellë mu në këmbë...
Bir'i shkëmbit ish plagosur;
Po me zëmër qe brumosur!
Çan korrijen tatëpjetë,
Kapérxen drizat, murrizat,
Heth rrëketë,
Zvarrë-zvarrë, çalë-çalë,
Kur më shpejt, kur me ngaoalë,
I kapitur, eshtra-mpirë,
Zuri fshatin ndaj të gdhirë!
As i vdekur, as i gjallë,
Mezi nxori këto fjalë:
— «Atje tej n'atë mazgallë,
Në të çarë,
Janë fshehur tre tradhëtarë... — »
Mbylli syt'i raskapitur,
Plumbi rënd'e pat goditur!...

* * *

C'ësht' ay fytyrë-mdritur,
Poshtë pllajës duke zbritur,
Kryet lart e synë prush?
Kush të jetë vallë, kush,
Ky bari që prin i parë,
Që heq lehtë këmbën zvarrë,
Me nishan mu mbi qepallë,
Një të fshikur nënë ballë?
Kush të jetë vallë kush,
Ky bari që prin i pari?
Mos u ngrit Brahu nga varri?

Shkuan vjet nga ajo natë,
E llahtarshme, pus-shterngatë,

Bir i shkrepit na u rrit,
Buçkaran e sy-astrit
Dhe mustaqja ca nga ca
Po i dërsit.

Taman si i ati,
Si lis derdhur shtati,
I biri xha Brahos,
Me krrabë në dorë,
Me fyell në bres,
Në shi e në borë,
Ç'na ecën serbes!
Mbi çdo brigadier,
I parë qëndron,
Ky shqipe-skifter!
Në xhep abetaren,
Nga pas ndjell manaren.
Ç'ma ka synë pishë,
Dhe s'lë korb as bishë,
Që çerdhen shqiponjës
T'ia prishë.
Çdo ujk e çakall,
E pret, e përciell
Me plumb mu në ballë.

Në trungun e dushkut në stan,
Dërmit Balua plak veteran!
Dhe dhëmbët e mprehtë i ranë,
Dhe këmbët e shpejta e lanë,
Po prapë i rëndë na mbahet,
Kopesë s'i ndahet!
Dhe plagët në trup që ka marë
Në ndeshjet me bisha kusarë,
Tregojnë sa shumë beteja
Ka dhënë nér shkrepa, pllaveja.

Në mbrëmje, nërsa gjithë flenë,
Lëshon syt e zes mbi kopenë,
Dhe pyet vetvekten habitur:
— « Sa shumë na qënkërka rritur! — »
Pastaj rri menduar....
Kujton ndofta kohën e shkuar,
Kur malet dhe gërxhet dhe pyjet,
Një mjergull e tym pat mbuluar!
Kur tërë kopeja në stan
Vajtonte mavrinë çoban
Q'u çduk dhe s'la gjurmë as nishan.
Kur këngës Astriti ia thotë,
Një kënge të ngrohtë, të ngrohtë
Lëviz bishtin lehtë....
Dhe ndofta mendon me vetvehtë:
— « Përse çoban Brahua më parë,
ia drithte gjithmonë me të qarë? — »
Sërisht lëviz bishtir, gëzuar
Diçka dhe ay ka kuptuar.

Astriti i parë nér male,
Ç'na prin një kope blegtoreale,
I biri xha Brahos krenar,
Na qënka m'i pari dhenar!
Sy-shkabë po ecër Astriti,
Se rrugën Partija ia ndriti;
Dhe syt i mbërthen ky çoban,
Drejt rrugës që populli çan.
Nga larg sjell jehona mbi male,
Buçima traktorësh nér ara,
Në fshatra me hidrocentrale,
Një popull po ecën përpara.
Marshon me besim vegjëlia
E prin ngadhnimtare Partia.

Aty më tē zbardhur mëngjes,
Kur rrezja vargmalet i năes,
Astriti me fyell ia thotë,
Një kënge tē ngrohtë, tē ngrohtë:

« — Në pyll ç'po ia thotë bilbili,
Me vesë po lahet trifili,
Aromë shpérndan trendelina,
Çan qiejt me vrull gjeraqira!
U çporr nga ky vënd dimri rëndë,
Kur bujku zvarrit mbi parmëndë,
Kur sorrat e qjellit çobanit,
I trëmbyninë delet e stanit.
Mbaroi përgjithmonë ajo natë,
Kur endesh pa shpresa i ngratë,
Ky popull azgan i pafatë.
Lum ne sa u rritëm o shokë!
Sa shumë u zgjerua kjo tokë!
Sa miq kemi ne! Miq me kokë,
Me qindra e qinôra miljonë,
E duan me shpirt vendin tonë.
Shiko si lulëzon një pranverë,
Që kurrë s'u pa tjetër herë!
Shiko si një popull jetë-gjatë,
Q'u ndryth mot e shekuj bukë-thatë,
Po ecën drejt rrugës shpëtimit.
E prin ajo drit'e Leninit,
Që feks dëzyet vjet e pashterrur,
Nga zemr'e çelikt'e Kremlinit.»

Kështu Astrit Brahua ia thotë,
Një kënge tē ngrohtë, tē ngrohtë.

PROZA POETIKE

Mësim letërsie¹⁾

Ish ora e mësimit të letërsisë në shkollën e Partisë. Nxënësit e kishin shumë qejf atë lëndë.

Aty nga fillimi i vitiit kur mësonjësi u kish folur për pionierët e mbëdhënëj të Rilindjes, për Saminë, Naimin, Çajupin, Vaso Pashën, shumë nga ata kishin mbetur gojë-hapur për thesarin e madh të letërsisë sonë klasike.

Ishin djem të pjekur. Rrethanat nuk i kishin lejuar të dëgjojnë tjetër herë këta emra. Disa syresh as kishin parë ndonjëherë shkollë me sy. Ishin bij të njerkës që kish mbytur mjergulla e errësirës. Abetaren e kishin mësuar vjedhurazi atje lart majë shkrepit, përmes tymit e flakës. Ndaj, etja që kishin për kulturë ish tepër e madhe. Ata u përngjisnin atyre shtegtarëvet të arratisur në shkretëtirat e Saharasë, që u është tharë gjuha për një pikë ujë, dhe kur u del përpara lumi i kulluar, u vjen ta përpijnë të tërë me një gllëng. E tillë ish etja e tyre për kulturë! Ishin burra me fëmijë një pjes'e tyre, po kjo nuk i pengoi të uleshin në bankat e shkollës, si nxënës të thjeshtë.

Kur u shpërnanoanë retë dhe u largua stuhija, ata që mbetën u kthyen, aq e një pjes'e tyre filuan luftën tjetër, luftën për kulturë.

Pikërisht me nxënës të tillë ngjau ajo që rrallë murd të ngjasë në një shkollë tjetër.

1) Kjo copë dhe dy të tjerat, janë ngjarje të vërteta.

« — Sot — filloi profesori — do të flasim për Letërsinë e luftës Nacionale Çlirimtare. Do të zhvillojmë epokën letrare që meret me luftën e madhe të popullit tonë, kundra pushtonjësit fashist, nazist dhe matrapazëve t'atdheut.» —

Për një çast balli i nxënësve ndriti më tepër se kurrë dhe syri u mbërthye në buzët e profesorit.

« — Letërsia e Luftës Nacionale Çlirimtare i ka burimet e saj në traktet e para që hodhi Partia kur është kushtimin për liri.»

Nga e majta Halimi dhe Kiçua u shikuan sërish. Ishin nga ata që kishin shpërndarë traktet e para.

« — Kjo letërsi trajton heroizmat e komunistave të parë që u hodhën në zjarr e në flakë dhe u vunë gjoksir. tanksave të armikut.»

Në gjoksat e gjalla të nxënësve filluan të shkëlqejnë edhe më shumë dekoratat qhe shiritat e kuq çë nëmëronin plagët e marrura në beteja.

— « Shkrimtarët e letërsisë së luftës N. Çl. piktuorojnë djem të tillë që, kur preðha u rrëmber një dorë, e hedhin pushkën në tjetrën dhe vazhdojnë të luftojnë!» —

Celua me gishta të këputur dhe Astriti me një dorë, ulën sytë. Që të dy ishin nga ata.

Dhe profesori vazhdon... .

« — Letërsia e re na jep një pasqyrë artistike, reale dhe të gjallë të vajzës shqipëtare që krahës me burrir, hëngri barutin me grusht. Heroina si Zonja Çurre dhe martire si Margarita Tutilani e kthyen në realitet legjendën e lashtë të amazonave.» —

Selvia dhe Shpresa e vrejtën pakëzë fytyrën,

u skuqën dhe ia mbërthyen sytë njeratjetrës si-kur donin t'i thoshin diçka me ata sy.

« — Ne — vijoi profesori — do të shikojirë se si e pamundura u bë e mundur, se si tre batal-ljona të Brigadës së Parë, në zëmërën e dimrit, ka-luan nga jugu në veri, kapërcyen male 1800 met-ro të lartë, me dy metro borë, të goditur nga të katër anët prej armikut të tërbuar».

Islami, Prenga dhe Skënderi, u shikuani që të tre në sy është i buzëqeshënd njerit-tjetrit. Edhe kë-ka ishin nga ata.

Profesori desh të fliste edhe më. Desh i'u tregonte se si kjo letërsi përshkruan kampet e Vdekjes, Prishtinën, masakrat në masë, Borovën, se si u përmbyssën kullat shekullore të bajrakta-rëvet është oxhaqet e bejlerëvet, po s'mundi...

Heronj të gjallë të faqevet më të lavdëshme të historisë sonë, nxënësit shikonin, vehten e tyre të pasqyruar në këtë letërsi. Ishin ata vetë disa nga germat e kuqe dhe të lavdishme të faqevet më të bukura të historisë sonë.

Historia ishte shkruar rë ballë të protagonistave të gjallë. Në atë orë të paharruar profesori s'pat nevojë për libra se i kish para tij të gjalla, e të pavdekëshme.

Dy Zenelat

Eshtë koha e provimeve. Edhe pak nxënës kanë mbetur pa u pyetur; jan' ata të cilëvet u fillon emri me gërmat e fundit të alfabetit.

Profesori hap regjistrin dhe i ndal sytë aty te gërma Z.

— Sot kemi për të komentuar «Zenelin», copën e bukur të shkrimtarit Migjeni; pra, Zenel për Zenel, ngreu ti, Zenel, dhe na folë! —

Një djalosh aty rrötull të tridhjetavet, i shkattë, buçkarran, pak si i turpëshëm, me dy sy të lëvizëshmë, ngrihet është i afrohet katedrës.

E quanin edhe atë Zenel si «Zeneli» i copës që do të komenton. Për çudi edhe dialekti që fliste ishte ay i veriut.

Dukesh pakëzë si i tronditur. Fytyra i skuqte flakë dhe pa filluar mësimi, djersët nisën t'i kullojnë rrëke.

«Ndofta nga vapa, tha me vehte profesori.»

— Fillo, Zenel, lexo!

Po Zeneli hesht!

— Hë pra, fillo — i a preu profesori si me pardurim, po me të butë.

Po Zeneli vazhdon të heshtë.

Klasa, e cila gjer r'atë çast dukesh pak si e çthurur, i pushoi murmuritjet është lëvizjet dhe i a mbërtheu sytë nxënësit, që kish mbyllur buzët dhe s'donte të thosh mësimin.



5 — Frymëzime nga jetë e re

— Me gjithë se s'është e rregulltë — tha profesori — po lexoj unë pjesën nga Zeneli i Migjenit dhe ti do ta komertosh. Dhe profesori nisi të lexojë:

... «Nga një herë rrallë Zenelit i mbushet mërdja dhe thotë: s'di zotni! është duket sikur më qorton e sikur më thotë: — mjaft zotni na mësuat si duhet të jetojmë ne në Pukë. Na shiko mirë! Njanit nëpër këmishë të shqyeme i duket supi, tjetrit i duket barku si arrasë, atij atje është gadi t'i bjerë të fikët nga uria. Shpesh mendoja për të arthem e Zenelit. Por vullneti im nuk mjafton për ta ngritur Zenelin në majat e nalta ku shkapërt hejrnë horizontet e dritës.»

Dhe si mbaroi së lexuari copën e Migjenit, profesori i thotë Zenelit:

— Tashti folë Zenel dhe mos u bëj xanxar si Zeneli i Migjenit!

Po buzët e Zenelit vazhdojnë të qëndrojnë përsëri të mbërthyera.

— Un'e di se ti ke shumë vjet që i ke prerë mësimet, po e kam shpjeguar këtë copë. Pastaj, mua më duket se ti je aq nga ato vise, ku Migjeni ka qënë mësonjës që duhet ta kuptosh më mirë, ta najesht më thellë. Nga je ti, Zenel?

— Nga Puka.

— Aqë më mirë, se tamam për atë krahinë flet poeti.

Zeneli me libër në dorë, me sytë për tokë, si i hutuar, hesht!

Durimi i profesorit i kapërxen kufitë. Një shok nga bankat e para i pëshpëriti Zenelit:

— Folë, mor qyq, se ta këputi dyshin.

Në atë çast Zeneli ngriti kryet, e shikoi profesorin në sy, dhe nga buzët e tij u çkëputën këto fjalë:

— S'mundem! . .

Heshtjen e theu zëri i një nxënësi nga fundi i sallës:

— Është ay!

— Si the ti Sulë? Si the?

Dhe Sula përsërithi:

— Është ay vetë, Zeneli i copës!

— Ky është dora vetë Zeneli që ka përshkruar Migjeni në copën e vet. — Përsërithi nxënësi me zë të fortë prej malësori.

— Vërtet ti?

Po Zeneli vazhdon të heshtë!

Nxënësit ngrihen në këmbë për ta parë më mirë. As profesori s'di nga t'ia mbajë. Para kësaj koincidence shumë të rrallë në jetën shkollore, ku personazhi letrar është realitet i gjallë ahe shikon si përmes një èndërr vetehten në të kaluarën, profesori e harron provimin dhe sodit Zenelin e heshtur, viktimë të kuriozitetit të klasës.

Mbretëron heshtja në klasë. Dhe përmes kësaj heshtjeje, rë sallë vërtiten qy Zenela!

Njëri thatanik, zbatharak, i tretur, i zymtë, pa jetë, pa shpresë, bir i vuajtjes dhe i errësirës, tjetri i gjallë, burrë, optimist, ngadhënyes rë jetë!

Dy Zenela! Jo! S'ka dy Zenela! Zeneli bir i njerkës jeton vetëm në copa letrare për të na treguar shëmturirë e një bote të ndryshkur dke të perënduar për gjithënjë.

Zeneli, bir i Partisë, ësht aty para nesh i gjallë dhe me heshtjen e tij flet.

Mësimi merr tjetër drejtim. Mësim në heshje! Një heshtje që flet! Asnjeri s'pipëtin dhe të gjithë ëndërrojnë. Zeneli i mallëngjyer ka lënë të flasjin përtë dekoratat që i zbukurojnë gjoksin, triskën e Partisë që e ruan pranë zemrës, si syt' e ballit.

Me mijëra Zenela sulmonjës për jetën e re parakalojnë në klasë në atë orë të jashtëzakonëshme, të kredhur në një atmosferë meditacioni.

Aty parakalon në tërë maadhështinë e saj Shqipëria. Kombinati që end këmisha për Zenelat e rinj, lugina e Matit plot zhurmë, që do t'u japë drithë «... malësorëvet me një këmishë dhe brekë le-gjendare mbi shtat; kraharori i të cilëvet është një copë graniti që u çkëput nga mali dhe u venaos mbi dy këmbë të drejta, të forta si lënoa e pyllit».1)

Parakalon kanali i Myzeqesë cë do të zgjidhë përgjithmonë «Legjendën e misrit», fusha e gjelbëruar e Maliquit që ëmbëlson gojën e këtij populli të farmakosur prej shekujsh shtypjeje dhe robërije,

Antitezë tragjike dhe madhështore! Ky ishte thelbi i mësimit të asaj ore të paharruar.

Dy Zenela! Dy epoka! Dy botë në luftë njëra me tjetrën, e dyta ngadhënyese ndaj së parës..

Sikur të ish aty edhe Migjeni e ta sodiste Zenelin e tij të rritur, të gjallë, q'do të thosh vallë?

Buzëplasuri Migjen sigurisht do të buzëqesh-te; dhe kjo do të ish ndofta e para buzëqeshje në jetën e tij!

1) Nga copa: «Legjenda e misrit».

Fytyra e zymtë, e zbehtë e Poetit do të reze-tonte kur të shikonte me mijëra Zenela që po lu-lëzojnë në kopshtin e math të Republikës. Do të shikonte Zenelin, birin e Partisë, të rrashur në luf-të e në jetë, dhe për të parën herë do të shpërthen-te nga gjoksi i Foetit «Kënga e Pakëndueme», ajo këngë që s'u këndua kurrë prej tij, që u varros bashkë me t'ë! Muza e tij e ngrysur ao të çelej nga-dhnimtare, do të ligjéronte këngë për jetën e re, sa do të buçiste jo vetëm malësia, po gjithë Shqipëria:

Fuqi e mrekullushme kjo jotja
O. Parti,
Që skllavit i dhe jetë dhe frymë
Dhe Liri.
Buçit o këng' e bukur, o kënga e Rinisë
Këndo o lyra ime, m'i thur lavdi Partisë!

Po këtë këngë Poeti s'e këndoi. E kënduan me mijëra të rinj me yll në ballë. «Kënga e pakënau-me» u këndua. E kënduan Zenelat e rinj.

D r i t i

— Sot — tha profesori — do të bëjmë fjalë për shkrimtarin e dëgjuar sovjetik, Nikollai Ostrovskin.

Jeta e tij është një epope e tërë: një tragjedi e hidhur, por madhështore. Humbi ëritën e syrit disa vjet para se të viste, dhe megjith'atë përmes mjergullës s'errësirës në të cilën ish kredhur, vazhdonte t'u epte dritë të tjerëvet. Si një Homer i dytë, i verbër ay këndoi epopen e lavaishme t'at-dheut të socializmit. Dhe me gjithëse i verbër ay shikonte se penën e vet e ngjyente në afshin e idealit të partisë...»

... Këtu profesori pa pritmas e këputi mësimin në mes, e uli zërin dhe lehtë—lehtë kafshoi buzët. Aty nga fundi i sallës së mësimit i zuri syri diçka që e mallëngjeu; një rxënës i verbër, çë s'e kish parë tjetër herë, gjindesh në klasë dhe po dëgjonte mësimin. Në dy sytë e atij nxënësi, në oy zgavra të zeza të mbërthyera në boshllék, shkëlçenin dy lot të kristaltë.

Ishte Driti! Ky qe takimi i parë me Dritin.

Aty rrrotull vitit 1943 Driti po shpinte korespondencën nga një bataljon në tjetrin dhe gjermanët e kishin kapur dhe e kishin internuar në kampi famëkeq të Mathausenit. Atje humbi është dritën e syrit.

Dhe kur populli ynë filloi të jetojë në dritë,
Driti u kthyte nga skëterra pa dritë.

Bursist i shtetit në liceun artistik, ay hynte klasë më klasë dhe dëgjonte mësimin; por profesori i ri i shqipes, nuk e dinte këtë gjë, prandaj u habit kur e pa është për një çast ndërpreu mësimin. Pastaj mësimi mori një tjetër drejtim. Profesori shikonte Dritin dhe fliste për Ostrovskin, veç mëtesh që të mos i lëndonte plagët rrxënësit të verbër.

Kur u fol në klasë për shembullin madhështor të të Sëmurit të Madh, që edhe kur lëngonte në shkronje, vazhdonte t'i shërbente atdheut është rixerëzimit, Driti i thëthiu lotët dhe në buzet e tij u shfaq një buzëqeshje. U duk sikur iu çà perdja e zezë, që i kishte zënë sytë. Kur mbarto mësimi i afrohet profesorit dhe i thotë:

— Mund të ma, jepni për pak ditë librin «Si u kalit çeliku»? Profesori aty për-aty nuk u mendua thellë po vuri dorër. në çantë, pastaj ia pret:

— Don ta lexosh Drit?

— Po, po, pse jo? — tha Driti.

Profesori s'e zgjati më, por i dha librin.

Më vonë e mori vesh prej shokëve të Dritit se ay nuk e bënte kurrë vehter të verbër; se të tjerët i a lexonin librat dhe ay e çuanë sikur e kish lexuar vetë.

Driti e dëgjon shkrepjen e minavet, por hidrocentralin nuk e sheh! Në veshët e tij fishkëllen sirena e lokomotivës, po lokomotivën nuk e sheh! Zëri i stakanovistikës të kombinatit kumbar në veshët e tij, po kombinatir nuk e sheh. Këmisha që ka veshur në trup është endur në kombinatet tonë, por ay ngjyrën nuk ia çuan. I a ka rrëmbyer sytë shtrëngata. Po Driti jeton! Kur flet me' të është

sikur të thotë:- — Mos më shiko errësirën e syvet por dritën që zbarohëllon në shpirtin tim.

Është optimist. Mjergulla që i ka zënë sytë s'ka mundur të depërtojë në zemrën e tij. Gëzimi i një populli ka përshkuar eahe syt'e errët të Dritit dhe është rrënjosur thellë në shpirtin e tij.

Shpesh ay ecën rrugës vetëm dhe i heth hapat aqë lehtë sikur t'i kish sytë në majë të gish-tavet të këmbës. Një ditë një shoku i tij i thotë:

— Drit, mos ecë vetëm rrugëvet, se mund të tē r. gjasë gjë!

Ahere Dritit i ra një nur e ja ndriti fytyrën; dhe nën ata dy sy pa oritë lëvizën ëy buzë r. e gaz.

— Unë shoh!

— Si?

U duk sikur nga buzet e Dritit u çkëputën këto fjalë:

«Unë shoh!... Jo vetëm rrugët e Tiranës, po dhe rrugën ku ecën një popull i tërë. Unë shoh atë popull kur këndon, kur dërsin, kur ngre t'arthmen e vet dhe unë kënaoj ahe dërsij bashkë me tē.

Unë shoh: edhe atë dritë q'u ep dritë syve të mi, që u dha dritë syvet t'Ostrovsit, që verbor armiqt tanë. Unë shoh Kremlinin! Sytë e mi padisin kasapët e rinj që mbrehin hanxharët për kasa-phane të reja. Në sytë e mi shkëlqen fjala p a - q e ..»

Dhe në këtë çast nxorri nga xhepi një tufë vjershash tē shkrojtura me dorën e tij; aisa nga ato i kish dërguar në shtyp.

— Unë shoh se më ka dhënë sy Partia!

Kënga e shqiponjavët

E njoha më shtatë prill.

Breshka këmishë-zezë me lëkurë luani dhe pëndë këndezi, e njohu dhe ajo.

Më vonë e njohu dhe vanoali i motorizuar.

Dhe pastaj nami i tij mori ëhenë.

E pashë kur braktisi shtëpi e katandi, kur lëftonte si skifter mbi malet tonë, kur ngjitesh gërxhevët përpjetë, atje ku shqiponja ngre folënë.

E pashë në një natë të thellë Shënëndreu, trup-përgjakur, këmbë-enjtur.

I paskish calë zot atdheut dhe vegjelisë!

E pashë ngrën'e pa ngrënë, kur pinte ujë në gjurmat e mushkës, kur u plagos, kur fshinte gjakun me mëngën e këmishës, kur vâiste me kërgë në gojë.

E pashë në trikëmbësh të varur. Po ai nuk vdiq!

E pashë kokë-prerë në fushat e Myzeqesë. Po ai nuk vdiq!

E pashë në Tirani, në Korçë e në Prishtinë të masakruar. Po ai nuk vdiq!

E pashë kur sulmoi si luan tanksin këmishëzi; e pashë të rrëthuar kur u dogj i gjallë me pushkë në dorë. Po ai nuk vdiq!

E pashë kur qëlloi mu në lule të ballit Tra-dhëtinë!

E rjoha në Pezë kur dha kushtimin, në Kur-

velesh me pallë sheshit, në Mallakastër kur hante barutin me grusht, në Vlorë kur lëftonte Një me një qint, në Korçë kur buçisrin malet e Gorës e t'Oparit.

E njoha n'Elbasan kur i është dërmën feudalit, në Mirditë, në Dibër e në Mat, kur përbësia kalatë e bajrakut dhe hodhi n'erë kullat e mercenarit.

Një ditë e gjeta në bisedim me kamzhikun. Ishte kapur në befasi. Kamzhiku e kishte lidhur kok'e këmbë! Po dhe kështu ja kishte frikën.

Duke fishkëllyer i thosh:

— Në do të shpëtosh, trego shokët! —

Dhe Ky me buzëçeshje, si me tallje, përgjigjesh:

— Shokët e mij? Nata e thellë si deti! Dita e bardhë si bora!

Dhe kamzhiku:

— Të tjerë!

— Të tjerë??

— Drita e zbehtë e hënës, tufani i çmerndur, breshëri i tërbuar.

Kamzhiku i egërsuar fishkëllen e pyet:

— Të tjerë!

— Urija, lodhja!

Po kamzhiku nuk ngopet! Kërkon edhe më, auke fishkëllyer.

Dhe Ai i a pret me zë të këputur:

— Dale kamzhik se më ka mbetur edhe Një. . . Atë e kam pasur gjithënjë pranë, shok të pandarë. Ai më mësoi si të përbys të dy skllavëritë, atë të pushtonjësit dhe atë të gjakpirësit vëndës. Dit' e natë, në gaz e në brengë, zgjuar ose në gjumë, në mal, ose në fushë, në tym ose në flakë,

kudo, në çdo vërd, nga çdo anë kam pasur si shok
të pandarë Part

.... Po kamzhiku i a këputi fjalër. në mes.

Po Ai nuk vdiq! Se Ai nuk vdes!

Ai ish si Anteu: Baba kish malin dhe Nënë
fushën.

Për ta çdukur ëuhesh të përbysnje malin.
dhe të çrrënjosnje fushën. Ai ishte si Akili! Plum-
bi e çponte vetëm në thembër:

Po Ai nuk ia ktheu kurrë shpinën dushmanit.

Dhe shqiponja që mbante zi në çerdhen e saj,
kur e pa, fërkoi syt'e habitur dhe pyeti:

— Cili të jetë vallë?

Këtyre gërxhevet kam parë Skënderbeun, Rra-
po Hekalir, Bajram Currin, Çerçiz Topullin, Se-
lam Musanë, por jo këtë!

Gjer më sot nuk më ka zënë syri trim si ky
me yll në ballë!

Ky u a kapërxeka të gjithëve.

Ky të marka gjak në vetull!

Ky i thënka tufanit: S'ta kam frikër! -

Ky i thënka rrufesë: — S'më zhurit dot!

Ky i thënka zjarrit: — S'më djek dot!

Ky i thënka mitrolozit: — S'më çpon dot!

Ky i thënka Mortjes: — Plaq!

Ky qenka më trim se urë! Unë lëftoj vetëm
në mal; ky lëftoka në mal, në fushë e në qytet!

Dhe shqipja vriste mëndjen për ta njohur.

Dhe e njohu!

Dy lot të turbullt gjëzimi rrëdhën nga syt'e
saj të shkathët dhe si dy rrëke xhevahiresh mu-
rën shkëmbin tatëpjetë.

Dhe shqiponja përplasi krahët tmerrësish;
fluturoi krenare, madhështore, e vrazhdë ëhe e

egër, shkëmb më shkëmb, gërxhe më gërxhe, për t'u dhënë shoqevet që ishin strukur nér të zeza në foletë e tyre, sihariqin e math.

— Paska burra që i dalkar zot tokës arbërore!

Dhe kënga e shqiponjavet buçiti si rrufe, sinfoni e pambaruar e këtyre malevet kreshnike, e këtij populli fatkeq, oë s'pa kurrë ditë të bardhë, që vëiste me fjalën Liri në gojë, po s'pa kurrë liri me sy.

Dhe kënga e shqiponjavet buçiti si rrufe:

«Se mjaft në robëri,


« E mjera Shqipëri...»

Dhe jehona gumëzhiti si bubullimë që nga Tomori e gjer në Nëmërçkë, që nga Korabi e gjer në malet e Çikës:

« Përmbi shkëmbir, e gurë,

« Liri do ngjallëm.»

Me mijëra yj xixëllonin mbi qiellin shqipëtar qhe rrethonin flamurin kuq e zi të çpalosur që valavitej krenar e i pampostitur rë ajrin e pastër të lirisë.



SATIRA

Epitat

Mbi varrin e poetit të panjohur

Gjatë gjithë jetës s'ime
Shkrova-shkrova
Po shumë pak botova.
Dhe fare pak fitova!
Askush nuk e përfilli muzën time
Që sot po lë jetime.

Harxhova letër, bojë dhe talent
Me okë,
Po s'pata fat o shokë.
Në vargje a në prozë
Më vajti puna bozë,
Dhe deti u bë kos,
Po un' e humba lugën,
Ndaj, drejt një bote tjetër
Mora rrugën.

Me vargje e me prozë
Si jorgan mbulomëni!
Novela e romane
Si qyshekë shtromëni.
Poema, drama, komedi,
Mbi varr këndomëni!
Dhe me talent mëkomëri.


Me pak humor kungomëni
Dhe me satirë lakmëni,
Spërkatmëni.

Unë shpresoj se lart mbi qiellin
E pamatur,
Shën Pjetri do më presë krahë-hapur
E ndofta do të thotë:
— Ku gjen si ky poetë
Me penë pjellore aq të mprehtë?-

Veç një merak më bren
Tashti që mbylla sytë
Mund ta them:
— Vallë atje lart në botën e paparë,
Do ketë honorarë?

Kursimi i fundit

Dhe kur po hiq për shpirt
Kopraci plak...
Kish hyrë në merak:
— Kurseva e kurseva
Verdhushka kam me okë...:
C'do mund të kursej vallë
Tashti që hyj në tokë?...:
Mendohet e mendohet,
I gjori mer e jep,
Lëvis duar e këmbë
Si foshnjëza në djep:
Pastaj i thotë vektes:
— C'mund të kursesh në varr,
Qyqar more qyqar?
Mendohet... e mendohet...
Dhe si gëlltit pështymën,
— E gjeta! murmuriti —
— Në varr do kursej... frymën.



— Frymëzime nga jetë e re

Pesë rubai

G r a z h d i

O ti në arrati i çakërcisur,
 Në grazhdin e dushmanit je hazdisur,
 Je shtruar këmbë-kryq nëpër kolltukë
 Dhe i pangçpur... turpin ha me bukë.

I - d a m k o s u r i

Mbi gjoksin vula-vula i damkosur,
 Tradhtinë mu në gjak e ke rënjosur,
 T'valviten ngjyra-ngjyra mbi lëkurë,
 Si hajmali... dyzet e ca flamurë.

A n k a n d i

E shite Pejgamberin me flori:
 Në Vatikan të bleu një Zot i ri;
 Po nesër ti je gadi.. për kuletë,
 Të nxjerrësh në ankand ahe...Papën vetë 1)

S a h a n - l e p i r è s i

Në dorë një çanak, në bres një lugë,
 Po silllesh endacak rrugë-më-rrugë,
 Nuhat, lëpin e brren si qen pazarë
 Kokallat që të heth padron dollari.

Q e f i n i

Për vëndin ku je tundurë në djep,
 Qefin me dorën tënde sot po qep,
 — Qináise rrëth e rrrotullë me ar,
 Se vetë do të hysh, o mercenar.

1) Nga gjyqi i diversantëve në Tiranë, dolli se disa mercenarë shqiptarë t'arratisur n'Itali, ndrruan fenë për të holla.



Shëtitje letrare

Një ditë prej dite Vjershua, Prozua ëhe drama, vendosën të thyenin zinxhirat që i mbanin të mbërthyer nëpër kolktukë të zyravet dhe të dallir, e të shikojnë q'bëhet rrrotull tyre.

— Mjaft i pamë gjérat me syt e fantazisë! — Thanë ata.

Kështu passi këta tre shokë u gjendën në një mëndje, u nisen. Në udhëtim e sipër vunë re se Ata nuk i shin vetëm. Pas tyre një grup i madh njerëzish ecte i gjëzuar me kalem e me defter në dorë. Ca më të ritur, ca më të vegjël, ca tò urtë e ca zevzekë, me flokë të shpupritura n'erë, të hipur mbi krahët e praruar të frymëzimit, ata filluan udhëtimin e tyre letrar. Pas tyre me nge vinte kritikua. Të gjithë e kritikonin, por dhe ia kishin frikën.

Kur po kalonin në një pyll të diendur njeri prej tyre me kalem në dorë lidhet e thotë:

— Pylli s'para më pëlqen!

— Tamam! i a pret Prozua, — ka të ngjarë që të bijem pa pritur Në gojën e ujkut; se siç thotë proverbi shqip: Lumi fle, hasmi s'fle!

Vjershos i u ngritën flokët përpjetë nga zemërimi dhe deklamoji si në vargje këto fjalë:

— Çudi si nuk e ndjeni që po na ledhaton flokët era pranverore. Habitëm si nuk

u pëlqeka të dëgjoni kur çesh bilibili. Mua më duket një vënd mjaft i përshtatëshëm për frymëzime djaloshare; s'do t'ishte keq ta shikojmë me sy pyllin që shpesh e kemi kënquar pa e parë».

Fjalët e zjarra të Vjershos i prekën të gjithë shtegtarët. Shushurima e ujit e përzier me fërfellimën e gjethet i përgjigjesh jehonës së thellë të oshëtimës së malevet dhe të lumenjvet; tingëlli i zilevet dhe i këmborëvet, zëri i fyellit majë nonjë bregut aty pranë, buçima e traktorit e bënin këtë harmoni zérash akoma më tërheqëse.

Dramos i u ngritën flokët përpjetë dhe s'u përmbajt dot më; ashtu siç ish n'ekstazë dramatike bërtiti me zë të lartë: Toka jonë! Kjo është toka jonë. Bagëtija ëhe bujqësia u përkasin atyre që dërsitin; që të gjithë lëvizën kalemat dhe shënuan: Andrra e jetës sonë. Ndërsa po dilnin nga pylli, Vjershua dhe Prozua i kishin mbërthyer sytë thellë ëhe diçka po shikonin me vërejtje. Dy thëllëza, ëy vajza po ecnin me haça të shpejta. Njera mbante rë dorë një çantë, dhe tjetra, ajo më e vogla, kish nën sjetull një boçë. E pyet Vjershua atë më të madhen:

— «Cila je ti? Ku po shkon?

— «Jam Afërdita, po shkoj Përsëri në fshat. Çudi si nuk më njohe!

Pak si i turpëruar Vjershua murmuriti:

— M'u duke si e bukura e dheut.

— Ndofta! i a preu ajo duke qeshur; po deshe të njihem më mirë eja kohë mbas kohe atje ku vete unë. —

Tundi shaminë dhe u çduk si rrez'e diellit kur e mbulon reja. Pak më tej takuan vajzën tjetër me boçën nën sjetull, të shkathtë, të gjallë, të bukur si sorkaçhe mali. E pyet Dramua:

« — Si të quajnë moj vajzë?

— Jam Vajza nga fshati — i u përgjegj ajo, motra më e vogël e Aféraitës; po shkoj në qytet.

Dikushë pëshpëriti: — Ajo po shkon në qytet, kjo po shkon në fshat; dy rrugë për jetën e re; duhen vizituar që të dyja. Dhe shtegtarët muarën Udhën e Velanit.

Dhe udhëtimi vazhdoi më i kënëshëm se kurrrë.... Kaluan Sh teg më sh teg nér monopate ku kishin kaluar dikur Çlirimtarët. Këtu panë shumë gjëra dhe shumë kujtime u zgjuan në shpirrat e tyre për kokën e stuhisë pesëvjeçare. Buçisnin malet shqipëtare në Tingujt e revolucionit. Pastaj pa pritur filluan të këndojnë këngë të ndryshme: njeri i a kish marrë kërgës Fluturo pëllumb, tjetri Zgjimi i pranverës dhe një i tretë Shkolla jonë.

Po kënga buçiti akoma më e fortë kur nga maya e malit më të lartë u çfaq para syvet të Vjershos, të Prozës dhe të Dramos një pamje e mahnitëshme.

Fusha me pambuk të bardhë si dëborë, ara të gjelbëruara me paxhar, miniera me serë, me krcm e qymyr, kombinate stofash, druri, lumerjtë të vrullshëm nga të cilët çkëputeshin kanale, këneta në tharje e sipër, hidrocentrale të vegjël e të mëdhenj, njerëz që sulmonin me pistoleta, me

dinamit, me kazmë e me lopata; djem e çupa me libra nëpër duar, barinj e baresha që me një dorë mbanin krrabën dhe me tjetrër abetaren.

Majë kësaj tablloje të mrekullueshme është shumëngjyrëshe shkëlqenin këto shkronja: *S h q i - p è r i a e r e*. Dhe mbi çdo shkronjë xixëllonte ylli mbi ballin e shqiponjës.

« — Dëgjoni si Euçet Osumi! — Bërtiti Vjershua.

« — Vini re si po rritet Bereqeti! — ia preu nga ana tjetër Prozua.

« — Hidhni sytë atje thellë dhe shikoni atë fushë të madhe; *A s h t u M y z e q e!* — Deklamoi përsëri Vjershua.

Ndërsa kishin marrë rrugën e kthimit takuan rrugës një barkmath mustaqe-gjatë çë bënte ç'bënte dhe hiçhte sytë nga deti...

« — Është një nga ata që *N a h o q è n c a - t i n è* dhe që tashti e ka shembur *P è r m b y s j a!* Ndaj mban sytë nga deti; është e vetmja shpresë që i ka mbetur.

Në kthim e sipër qelli kish filluar të vrenjtet dhe të nxihet si plumb. Një erë e tërbuar filloi të fryjë dhe ish aq e fortë, sa për pak u shkuli flokët e kokës shtegtarëvet tanë. Një shi i rreptë filloi të bjerë si me shtëmba. Vjershua i zili i kish në gjak hiperbolat, thirri: — Shokë, dit'e qiamitet; ombrella s'kemi, gjithkush të mbulohet me shkrimet e veta. —»

Dhe ashtu u bë. Kur pushoi shiu shumica ishin lagur është ishin bërë qull. Kush që mbrojtur prej shiut me nonjë novelë, kush me nonjë fragment romani, kush me nonjë skeç, kush me nonjë dramë, kush me nonjë komedi, kush me nonjë po-

emth (të tillë pati mjaft), kush me vjersha, kush me vargje, kush me hiç.

Por, nuk ishte vetëm ujët e shiut që i lagu shtegatarët tanë; mjaft vargje dhe proza, skeçe, drama e komedi dhe romane, të ujëzuara çkrinë dhe ato dhe muarën rrëke tatëpjetë kurrizin e udhëtarëvet.

Nga pas, shumë pas me hapa të ngadalta vinte Kritikua.

Këpucët e shkëtarëvet ishin bërë me baltë, hekuri i pantallonave ishte prishur, gjunjët kishin filluar t'u thernir nga lodhja; me gjithë atë askush nuk u ankua. Përkundrazi! Filluan të këndojnë së bashku përmes Ngjyravet të Ylberit këngët e botës së re.

Dielli filloj të kukëzohet përmes revet. Udhëtimi po merrte fund. Që të gjithë kthyer e është një herë kokën, i a mbërthyen sytë panoramës shumë-njyrëshe, tundën kalemat është bërtiten spanjollce:

— Hasta La Vista!

Një zë i fortë buçiti thellë dhe jehora tingëlli akoma më e fortë në veshët e Prozos, të Vjershos dhe të Dramos:

— Mos na harroni! Mirë u pafshim për së shpejti!

C'zë i fuqishëm ish ay! Pa'të, muza thinjet, pena ndryshket dhe vargu fishket pa u tharë akoma boja. Ishte zëri i realitetit.

Ishte zëri i jetës!

Diagnozë pozitive ¹⁾

U mblohdë doktorrë
Grumbull shkëncëtarë
Kolonialistin vanë për ta parë.
I shikuan trupin, i panë dhe gjakun,
I preknë pak dellin, i hapën stomakun,
I panë dhe trurin.
Kok' e këmbë e panë,
Tërë të sëmurin,
Dhe pastaj i thanë:
— «Aty pranë gjirit
Sëmur.dj'e Misir.it.
E therur' e mezit
Sémundj' e Suez.it.
Trubullir' e trurit
Rrematizm' e gjurit,
Ose ndofta është
Sémundj'e v a j g u r i t.
Pranë mushkërive
Eth' e kolonive.
Ç'të rrjeth djers' e ballit
Si uj'i k a n a l i t !»
Ashtu siç ish shtrirë
Duke psherëtirë

1) Me rastin e dorëheqjes së Idenit për shkak të falimen-timit n'Egypt.



Kolonialisti
Pëshpërit ngadalë:
— Vuaj nat' e ditë,
Qafsha kolor.itë,
Çfarë djall të jetë
Kjo sëmundj'e shkretë?
— Sëmundje tipike,
Sir, diplomatike!
— Cili ësht' ilaçi,
Që të shkojë e keqja?
— Një ilaç i hidhur
Mister. . . . D o r ë h e q j a!